



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 336/8 prot.

Datë 02.03.2026

V E N D I M
Nr. 318/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për ankesën e operatorit ekonomik “GJEOKONSULT & CO” SHPK në procedurën e prokurimit për procedurën e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-70301-11-26-2025, me objekt “Projektim i objektit “Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville”, me fond limit 53,414,672.00 (pesedhjetë e tre milion e katërqind e katërmbedhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Kamëz Sh.a.

Ankimues:

Operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” SHPK me NIPT K91810005U dhe adresë Njesia Administrative Nr. 05, Rruga Sami Frasheri, Pallati Nr. 45, Shkalla 01, Kati i pare, Zona Kad, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Ujësjiellës Kanalizime Kamëz Sh.a me adresë: Rr. “Paqësori”, Frutikulturë, Kamëz

Subjekt i interesuar:

BOE “InfraKonsult” Shpk me NUIS L21512022F me adresa: Njesia Bashkiake nr.8, rruga "Qemal Stafa", shkalla 1, kati 0, perballe Qendres Lincoln, ZK 8370, nr pasurie 9/, Tiranë & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I****Vlerësimi paraprak**

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lart monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

1.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

1.4. Operatori ekonomik animues, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27.11.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-70301-11-26-2025, me objekt “Projektim i objektit “Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville”, me fond limit 53,414,672.00 (pesedhjetë e tre milion e katerqind e katermbedhjetë mijë e gjashtëqind e shtatedhjetë e dy) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.a.

II.2. Në datën 29.12.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 20.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | | |
|---|---------------|----------------|
| 1. INSTITUTI DEKLIADA-ALB shpk | 48,073,205 | I skualifikuar |
| 2. BOE GRAMA shpk & ZENIT & CO shpk | 48,073,205.28 | I skualifikuar |
| 3. BOE InfraKonsult shpk
& “ARABEL” SHPK
& “Transport Highway Consulting” SHPK
& “Civil Cons” Shpk | 48,100,000 | I kualifikuar |
| 4. GJEOKONSULT & CO shpk | 52,346,378 | I skualifikuar |

II.4. Në datën 28.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim -Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku fitues është shpallur BOE “InfraKonsult shpk” & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 10 datë 02.02.2026.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi nr. A/2026/6303, si dhe nr. protokoli 336/2026 datë 03.02.2026 e operatorit ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE

“InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, i cili nuk përmbush kriteret e vendosura për kualifikim sipas kriterëve të kualifikimit të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 336/1 prot., datë 04.02.2026, lidhur me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, i cili nuk përmbush kriteret e vendosura për kualifikim sipas kriterëve të kualifikimit të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Me shkresën nr. 336/2 prot., datë 09.02.2026, të protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, subjekti i interesuar BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, ka dërguar një shkresë me objekt: “Vënie në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik dhe Autoriteti Kontraktor”.

II.8. Me shkresën me nr. 268/2 prot., datë 10.02.2026, autoriteti kontraktor ka dërguar një shkresë me objekt: “Informacion për shtyrje afati”, protokolluar me tonën me nr. 336/3 prot., datë 12.02.2026.

II.9. Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, autoriteti kontraktor ka dërguar vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (Vendim me nr. 124/5 prot., datë 24.02.2026), protokolluar me tonën me nr. 336/4 prot., datë 25.02.2026, ku rezulton se, ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK.

II.10. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr. 124/6 prot., datë 24.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 336/5 prot., datë 26.02.2026, ka përcjellë vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimin e plotë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK, duke argumentuar si më poshtë vijon: [...]

VENDIM

DREJTUAR: **TITULLARIT TË AUTORITETIT KONTRAKTOR**

LËNDA: Vendim i Komisionit të ngarkuar për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit lidhur me ankesën e **GJEOKONSULT &CO** për procedurën e prokurimit publik “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, shpallur nga Autoriteti Kontraktor, Ujësjetës Kanalizime Kamëz Sh.a, me objekt: “Projektim i objektit Linje e re Transmetim Boville Pika 0 me tub çeliku D=700mm;L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville”, me numer **REF-70301-11-26-2025**, me fond limit 53414672 (pesëdhjetë e tre milion e katërqind e katërdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa tvsh, publikuar më datë 27.11.2025.

1.Pas shqyrtimit të ankesës, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimes, Komisioni i ngarkuar me urdhër nr prot 124/4datë 04.02.2026 për shqyrtimin e ankesës, konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në nenin 110 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

2.Operatori ekonomik ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor, në këto kushte Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit me pezullimin e procedurës u investua për të marrë në shqyrtim objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

3.Në VKM 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar në neni 100 thuhet. Në rastin kur, për shqyrtimin e ankesës, autoriteti/enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar,afati nuk duhet të tejkalojë 30 (tridhjetë) ditë.

Autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik,

ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit. Komisioni i shqyrtimit të ankesës me shkresën nr. 268/1 datë 09.02.2026, ka venë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik dhe ankuesin për shtyrjen e afatit pasi për shqyrtimin e ankesës është dashur të merret informacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe Gjykata e Apelit Tiranë.

Rrethanat e çështjes:

Më datë 27.11.2025 nga Njësia e Prokurimit, ngritur me Urdhërin e Brendshëm **nr.2593/4, datë 18.11.2025** Urdher Prokurimi me objekt: "Projektim i objektit Linje e re Transmetim Boville Pika 0 me tub çeliku D=700mm;L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville" është hedhur në SPE procedura e prokurimit publik, me fond limit: 53,414,672 (pesëdhjetë e tre milion e katërqind e katërdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH.**

Formulari i Ankesës është depozituar nga Operatorit Ekonomik **GJEOKONSULT & CO** me NIPT K91810005U dhe adresa Njësia Administrative Nr. 05, Rruga Sami Frasheri, Pallati Nr. 45, Shkalla 01, Kati i pare, më datë 03.02.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Ankimuesi ngre pretendimet si vijon:

Operatori Ekonomik ngre pretendimin se skualifikimi i tij për sigurimin e ofertës është bërë në mënyrë të padrejtë. Pasi Operatori ekonomik GJEOKONSULT & CO shpk ka paraqitur sigurimin e ofertës për 150 ditë në kundërshtim me DST ku përcaktohet 180 ditë.

Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit, pasi shqyrtoi ankesën dhe dokumentacionin që disponon në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit,

ARSYETON:

Në nenin 83 të ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik thuhet se:

1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:

- i. në formën e garancisë bankare; ose
- ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.

Në nenin 30 pika 3 të Vkm 285 datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, **bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës**. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.

Për sa më sipër kohëzgjatja e mundshme e procedurës e përcaktuar në dokumentat e tenderit dhe njoftimin e kontratës është 3 muaj.

Operatori ekonomik ka sjellë sigurimin e ofertës që është sa 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës me afat 150 ditë ky sigurim oferte është i vlefshëm gjatë të gjitha fazave kritike të procedurës prokurimit dhe periudha e vlefshmërisë së sigurimit të ofertës është i vlefshëm për gjithë periudhën e mundshme të kontratës.

Në rast se, për arsye objektive, procedura e prokurimit tejkalon këtë afat, legjislacioni i prokurimit publik parashikon mekanizma të qartë dhe të ligjshëm për administrimin e situatës, duke i dhënë autoritetit kontraktor të drejtën t'u kërkojë operatorëve ekonomikë zgjatjen e vlefshmërisë së ofertës dhe, rrjedhimisht, edhe zgjatjen përkatëse të sigurimit të ofertës. Vetëm në rast se operatorët ekonomikë nuk pranojnë një zgjatje të tillë, oferta e tij do të refuzohet pa u cenuar ligjshmëria e procesit.

Në rrethanat konkrete, sigurimi i ofertës është paraqitur në mënyrë të rregullt, në vlerën e kërkuar, në formën e pranueshme nga autoriteti kontraktor duke marrë në konsideratë dhe vetë afatet e VKM 285/2021 dhe me një vlefshmëri që mbulon plotësisht fazën thelbësore të procedurës së prokurimit, përfshirë periudhën e vlerësimit, marrjes së vendimit përfundimtar zgjatjen e mundshme të kontratës.

Cdo operator ekonomik në momentin e lidhjes së kontratës dorëzon edhe sigurimin e kontratës për gjithë periudhën e vlefshmërisë së kësaj kontrate.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

Ankimuesi ngre pretendimet si vijon:

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërbushjen e kriterëve si më poshtë vijon:
Shtojca 9 [Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor] FORMULAR I I KRITEREVE

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar. *Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur. Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës. Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore. 3 Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër. — Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet : Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit. — Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit, pasi shqyrtoi ankesën dhe dokumentacionin që disponon në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit,

ARSYETON

Komisioni i shqyrtimit të ankesave mori në shqyrtim të gjithë dokumentacionin e sjellë nga operatori ekonomik BOE Infrakonsult shpk Nipt L21512022F, 43 % Arabel Studio shpk NiptL51812001S, 20 % Transport Highëay Consulting Shpk Nipt K51428048I, 18% Civil Cons Shpk me Nipt L81315015O, 19 % ku përfaqësues ligjor është Arabel Studio Shpk ku u konstatua se operatori ekonomik ka sjelle dhe dokumentacionin fizik për të gjithë kriteret e mësipërme të përmbushura nga operatori.

Në pikën ç të kriterëve të përgjithshme thuhet se:

ç) se personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda

Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së .

Operastori ekonomik Arabel ka deklaruar se është i pa dënuar si dhe ka sjellë vërtetimin se personat që veprojnë si administrator janë gjithashtu të padënuar.

Komisioni i shqyrtimit të ankesave dërgoi shkresë për informacion gjykatës së parë të juridiksionit të Përgjithshëm Diber me nr prot 268 datë 09.02.2026 e cila me shkresën nr 395prot datë 19.02.2026 u shpreh se pranë gjykatës së rrethit Diber ka pasur një çështje penale konkretisht Nr 65(53801-00069-33-2024), datë regjistrimi 15.01.2024 me palë Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Diber dhe Ana Nishku e akuzuar për falsifikim dokumentash ,kryer në bashkëpunim më shumë se njëhër parashikuar nga neni 186/3 e 25i Kodit Penal.Sipas përgjigjes së komunikuar nga gjykata nuk është bërë ankim ndaj këtij vendimi për këtë arsye vendimi ka marrë formë të prerë me datë 22.02.2025. Gjykata ka vendosur deklarinin fajtor të pandehurës dhe denimin e saj me një vit burg. Në bazë të nenit 63 K.Penal, gjykata, urdhëron pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendesimin e tij me detyrimin e të të paditurës të përmbushë punë më interes prej gjashtë mujash pranë Bashkisë Tiranë.

Neni 76

Kriteret detyruese për skualifikim

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*

dh) falsifikim;

- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.*

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

Në rastin konkret personi i cili është denuar me vendim të formës së prerë është në cilësinë e Administratorit së një prej antarëve të BOE Infrakonsult shpk Nipt L21512022F, 43 % Arabel Studio shpk Nipt L51812001S, 20 % Transport Highway Consulting Shpk Nipt K51428048I, 18% Civil Cons Shpk me Nipt L81315015O, 19 % është denuar për një nga parashikimeve të nenit 76 dhe periudha e denimit nuk e ka kaluar afatin 5-vjeçar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Ankimuesi ngre pretendimet si vijon:

Kërkojmë të kryhet ekspertizë e posacme me qëllim verifikimin e ligjshmërisë dhe rregullsisë së procesit të vlerësimit të ofertave, konkretisht në lidhje me atribuimin e pikëve maksimale të OE të shpallur fitues. Ekspertiza e kërkuar duhet të përfshijë analizën e përputhshmërisë së vlerësimit të kryer nga autoriteti kontraktor me kriteret dhe metodologjinë e vlerësimit të përcaktuara në dokumentet e procedurës, verifikimin e dokumentacionit provues të paraqitur nga operatori ekonomik fitues, si dhe vlerësimin e respektimit të parimeve të barazisë së trajtimit, transparencës dhe proporcionalitetit, duke marrë në konsideratë ndikimin e atribuimit të pikëve maksimale në renditjen përfundimtare të ofertave”

Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit, pasi shqyrtoi ankesën dhe dokumentacionin që disponon në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit,

ARSYETON

BOE Infrakonsult shpk Nipt L21512022F, 43 % Arabel Studio shpk Nipt L51812001S, 20 % Transport Highway Consulting Shpk Nipt K51428048I, 18% Civil Cons Shpk me Nipt L81315015O, 19 % ku përfaqësues ligjor është Arabel Studio Shpk. Administratori i njërit prej antarëve të kësaj BOE është i dënuar me vendim të formës së prerë për një nga veprat penale të parashikuar në nenin 76 Të Ligjit Të Prokurimit Publik dhe duhet të ishte përjashtuar nga procedura e tenderimit dhe mosvlerësimin e mëtejshëm me pikë.

VENDOSI

1. Pranimin e plote të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik **GJEOKONSULT & CO** për procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-70301-11-26-2025 me objekt: “Linje e re Transmetim Boville Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville” dhe me fond limit: 53414672 (pesëdhjetë e tre milion e katërqind e katërdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH**, si të bazuar në ligj e në prova
2. Bashkangjitur përgjigja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe vendimin e gjykatës.

2. Një kopje e këtij vendimi i komunikohet menjëherë Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

3. Një kopje të këtij vendimi i dërgohet me shkrim Ankuesit.

4. Një kopje të Këtij vendimi i dërgohet Komisionit të Prokurimit Publik sipas rregullave të prokurimit publik.

Duke ju falenderuar,

Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendim

II.11. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga operatorët ekonomikë të interesuar sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur të saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues duke kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, i cili nuk përmbush kriteret e vendosura për kualifikim sipas

kritereve të kualifikimit të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, autoriteti kontraktor ka dërguar vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (Vendim me nr. 124/5 prot., datë 24.02.2026), protokolluar me tonën me nr. 336/4 prot., datë 25.02.2026, ku rezulton se, ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK.

III.1.2. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr. 124/6 prot., datë 24.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 336/5 prot., datë 26.02.2026, ka përcjellë vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK.

Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimin e plotë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK, duke argumentuar si më poshtë vijon: [...]

VENDIM

DREJTUAR: **TITULLARIT TË AUTORITETIT KONTRAKTOR**

LËNDA: Vendim i Komisionit të ngarkuar për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit lidhur me ankesën e **GJEOKONSULT & CO** për procedurën e prokurimit publik "Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar", shpallur nga Autoriteti Kontraktor, Ujësjetës Kanalizime Kamëz Sh.a, me objekt: "Projektim i objektit Linje e re Transmetim Boville Pika 0 me tub çeliku D=700mm;L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville", me numer **REF-70301-11-26-2025**, me fond limit 53414672 (pesëdhjetë e tre milion e katërqind e katërdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa tvsh, publikuar më datë 27.11.2025.

1.Pas shqyrtimit të ankesës, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimes, Komisioni i ngarkuar me urdhër nr prot 124/4datë 04.02.2026 për shqyrtimin e ankesës, konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në nenin 110 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar.

2.Operatori ekonomik ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor, në këto kushte Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit me pezullimin e procedurës u investua për të marrë në shqyrtim objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

3.Në VKM 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar në neni 100 thuhet. Në rastin kur, për shqyrtimin e ankesës, autoriteti/enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar,afati nuk duhet të tejkalojë 30 (tridhjetë) ditë.

Autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik,

ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit. Komisioni i shqyrtimit të ankesës me shkresën nr. 268/1 datë 09.02.2026, ka venë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik dhe ankuesin për shtyrjen e afatit pasi për shqyrtimin e ankesës është dashur të merret informacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe Gjykata e Apelit Tiranë.

Rrethanat e çështjes:

Më datë 27.11.2025 nga Njësia e Prokurimit, ngritur me Urdhërin e Brendshëm **nr.2593/4, datë 18.11.2025** Urdher Prokurimi me objekt: "Projektim i objektit Linje e re Transmetim Boville Pika 0 me tub çeliku D=700mm;L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville" është hedhur në SPE procedura e prokurimit publik, me fond limit: 53,414,672 (pesëdhjetë e tre milion e katërqind e katërdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH.**

Formulari i Ankesës është depozituar nga Operatorit Ekonomik **GJEOKONSULT & CO** me NIPT K91810005U dhe adresa Njësia Administrative Nr. 05, Rruga Sami Frasheri, Pallati Nr. 45, Shkalla 01, Kati i pare, më datë 03.02.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Ankimuesi ngre pretendimet si vijon:

Operatori Ekonomik ngre pretendimin se skualifikimi i tij për sigurimin e ofertës është bërë në mënyrë të padrejtë. Pasi Operatori ekonomik GJEOKONSULT & CO shpk ka paraqitur sigurimin e ofertës për 150 ditë në kundërshtim me DST ku përcaktohet 180 ditë.

Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit, pasi shqyrtoi ankesën dhe dokumentacionin që disponon në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit,

ARSYETON:

Në nenin 83 të ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik thuhet se:

1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:

- i. në formën e garancisë bankare; ose
- ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.

Në nenin 30 pika 3 të Vkm 285 datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, **bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës**. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.

Për sa më sipër kohëzgjatja e mundshme e procedurës e përcaktuar në dokumentat e tenderit dhe njoftimin e kontratës është 3 muaj.

Operatori ekonomik ka sjellë sigurimin e ofertës që është sa 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës me afat 150 ditë ky sigurim oferte është i vlefshëm gjatë të gjitha fazave kritike të procedurës prokurimit dhe periudha e vlefshmërisë së sigurimit të ofertës është i vlefshëm për gjithë periudhën e mundshme të kontratës.

Në rast se, për arsye objektive, procedura e prokurimit tejkalon këtë afat, legjislacioni i prokurimit publik parashikon mekanizma të qartë dhe të ligjshëm për administrimin e situatës, duke i dhënë autoritetit kontraktor të drejtën t'u kërkojë operatorëve ekonomikë zgjatjen e vlefshmërisë së ofertës dhe, rrjedhimisht, edhe zgjatjen përkatëse të sigurimit të ofertës. Vetëm në rast se operatorët ekonomikë nuk pranojnë një zgjatje të tillë, oferta e tij do të refuzohet pa u cenuar ligjshmëria e procesit.

Në rrethanat konkrete, sigurimi i ofertës është paraqitur në mënyrë të rregullt, në vlerën e kërkuar, në formën e pranueshme nga autoriteti kontraktor duke marrë në konsideratë dhe vetë afatet e VKM 285/2021 dhe me një vlefshmëri që mbulon plotësisht fazën thelbësore të procedurës së prokurimit, përfshirë periudhën e vlerësimit, marrjes së vendimit përfundimtar zgjatjen e mundshme të kontratës.

Cdo operator ekonomik në momentin e lidhjes së kontratës dorëzon edhe sigurimin e kontratës për gjithë periudhën e vlefshmërisë së kësaj kontrate.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

Ankimuesi ngre pretendimet si vijon:

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërbushjen e kriterëve si më poshtë vijon:
Shtojca 9 [Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor] FORMULAR I I KRITEREVE

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislationit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislationi në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar. *Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur. Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës. Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore. 3 Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër. — Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet : Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit. — Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit, pasi shqyrtoi ankesën dhe dokumentacionin që disponon në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit,

ARSYETON

Komisioni i shqyrtimit të ankesave mori në shqyrtim të gjithë dokumentacionin e sjellë nga operatori ekonomik BOE Infrakonsult shpk Nipt L21512022F, 43 % Arabel Studio shpk NiptL51812001S, 20 % Transport Highëay Consulting Shpk Nipt K51428048I, 18% Civil Cons Shpk me Nipt L81315015O, 19 % ku përfaqësues ligjor është Arabel Studio Shpk ku u konstatua se operatori ekonomik ka sjelle dhe dokumentacionin fizik për të gjithë kriteret e mësipërme të përmbushura nga operatori.

Në pikën ç të kriterëve të përgjithshme thuhet se:

ç) se personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda

Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së .

Operastori ekonomik Arabel ka deklaruar se është i pa dënuar si dhe ka sjellë vërtetimin se personat që veprojnë si administrator janë gjithashtu të padënuar.

Komisioni i shqyrtimit të ankesave dërgoi shkresë për informacion gjykatës së parë të juridiksionit të Përgjithshëm Diber me nr prot 268 datë 09.02.2026 e cila me shkresën nr 395prot datë 19.02.2026 u shpreh se pranë gjykatës së rrethit Diber ka pasur një çështje penale konkretisht Nr 65(53801-00069-33-2024), datë regjistrimi 15.01.2024 me palë Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Diber dhe Ana Nishku e akuzuar për falsifikim dokumentash ,kryer në bashkëpunim më shumë se njëhër parashikuar nga neni 186/3 e 25i Kodit Penal.Sipas përgjigjes së komunikuar nga gjykata nuk është bërë ankim ndaj këtij vendimi për këtë arsye vendimi ka marrë formë të prerë me datë 22.02.2025. Gjykata ka vendosur deklarinin fajtor të pandehurës dhe denimin e saj me një vit burg. Në bazë të nenit 63 K.Penal, gjykata, urdhëron pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendesimin e tij me detyrimin e të të paditurës të përmbushë punë më interes prej gjashtë mujash pranë Bashkisë Tiranë.

Neni 76

Kriteret detyruese për skualifikim

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) falsifikim;

e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

Në rastin konkret personi i cili është denuar me vendim të formës së prerë është ne cilësin e Administratorit së një prej antarëve të BOE Infrakonsult shpk Nipt L21512022F, 43 % Arabel Studio shpk NiptL51812001S, 20 % Transport Highëay Consulting Shpk Nipt K51428048I, 18% Civil Cons Shpk me Nipt L81315015O, 19 % është denuar për një nga parashikimeve të nenit 76 dhe periudha e denimit nuk e ka kaluar afatin 5-vjeçar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Ankimuesi ngre pretendimet si vijon:

Kërkojmë të kryhet ekspertizë e posacme me qëllim verifikimin e ligjshmërisë dhe rregullsisë së procesit të vlerimit të ofertave, konkretisht në lidhje me atribuimin e pikëve maksimale të OE të shpallur fitues. Ekspertiza e kërkuar duhet të përfshijë analizën e përputhshmërisë së vlerësimit të kryer nga autoriteti kontraktor me kriteret dhe metodologjinë e vlerësimit të përcaktuara në dokumentet e procedurës, verifikimin e dokumentacionit provues të paraqitur nga operatori ekonomik fitues, si dhe vlerësimin e respektimit të parimeve të barazisë së trajtimit, transparencës dhe proporcionalitetit, duke marrë në konsideratë ndikimin e atribuimitë pikëve maksimale në renditjen përfundimtare të ofertave”

Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit, pasi shqyrtoi ankesën dhe dokumentacionin që disponon në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit,

ARSYETON

BOE Infrakonsult shpk Nipt L21512022F, 43 % Arabel Studio shpk NiptL51812001S, 20 % Transport Highëay Consulting Shpk Nipt K51428048I, 18% Civil Cons Shpk me Nipt L81315015O, 19 % ku përfaqësues ligjor është Arabel Studio Shpk. Administratori i njërit prej antarëve të kësaj BOE është i dënuar me vendim të formës së prerë për një nga veprat penale të parashikuar në nenin 76 Të Ligjit Të Prokurimit Publik dhe duhet të ishte përjashtuar nga procedura e tenderimit dhe mosvlerësimin e mëtejshëm me pikë.

VENDOSI

1. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik **GJEOKONSULT & CO** për procedurën e prokurimit "Procedure e Hapur mbi kufirin e lartë monetar", me Nr.REF-70301-11-26-2025 me objekt: "Linje e re Transmetim Boville Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville"dhe me fond limit: 53414672(pesëdhjetë e tre milion e katërqind e katërdhjetë mije e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH**, si të bazuar në ligj e në prova
2. Bashkangjitur përgjigja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe vendimin e gjykatës.

2.Një kopje e këtij vendimi i komunikohet menjëherë Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

3.Një kopje të këtij vendimi i dërgohet me shkrim Ankuesit.

4.Një kopje të Këtij vendimi i dërgohet Komisionit të Prokurimit Publik sipas rregullave të prokurimit publik.

Duke ju falenderuar,

Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendim

III.1.3. Neni 30 i LPP-së i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: "1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ të pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankese nga operatorët

ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.

III.1. 5. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr. 124/6 prot., datë 24.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 336/5 prot., datë 26.02.2026, ka përcjellë vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimin e plotë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK. Në kushtet kur nuk janë paraqitur argumente nga operatorë ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni do të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. Nr. REF-70301-11-26-2025, me objekt “Projektim i objektit “Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville”, me fond limit 53,414,672.00 (pesedhete e tre milion e katerqind e katermbedhete mije e gjashteqind e shtatedhete e dy) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.a.

2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga BOE “InfraKonsult” SHPK & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, në zbatim të Vendimit të KSHA-së me nr. 124/5 prot., datë 24.02.2026, duke e skualifikuar këtë BOE.
 3. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK, duke e kualifikuar atë në zbatim të vendimit të KSHA.
 4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar	Anëtar	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anila Malaj	Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

